



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIATEPELENË
KËSHILLI

Nr.1468/2prot.

Tepelenë më, 01 . 07. 2022.

V E N D I M

Nr.53.Datë. 30.06.2022

“Për miratimin paraprak të planeve të mbarështimit pjesor të disa parcelave pyjore dhe kullosore, pronë e Bashkisë Tepelenë”

Këshilli Bashkiak Tepelenë në mbledhjen e datës 30/06/2022 pasi mori në shqyrtim kërkesën e Bashkisë Tepelenë, për miratimin paraprak të planeve të mbarështimit pjesor të disa parcelave pyjore dhe kullosore, pronë e Bashkisë Tepelenë, bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetqevrisjen vendore“e ndryshuar, neni 27 pika 5 dhe neni 54; ligjin 57/2020”Për pyjet” neni 11 pika 2b; dhe ligjin nr.9693 datë 19.03.2007 “Për fondin kullosor”, e ndryshuar; në VKM nr. 433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkisë të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listës së inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish- Komunave/Bashkive”, të ndryshuar; Urdhri Nr. 124 datë 04.12.2020 të kryetarit të Bashkisë Tepelenë “Për ngritjen e Komisionit për vlerësimin, verifikimin dhe hartim të planeve të mbarështimit pjesor për pasuritë e paluajtshme të llojit pyje dhe kullota”;

V E N D O S I:

1. Të pranojë kërkesën e Bashkisë Tepelenë “ Për miratimin paraprak të planeve të mbarështimit pjesor të disa parcelave pyjore dhe kullosore, pronë e Bashkisë Tepelenë ”
2. Të miratojë dokumentin “Plan mbarështimi pjesor për pyjet dhe kullotat pronë e Bashkisë Tepelenë“, për mbarështimin e 1 (nje) ngaster kullosore të ekonomisë kullosore Kurvelesh, 7 (shtatë) ngastra kullosore të ekonomisë kullosore Dukaj-Luzat, 1 (një) ngastër kullosore të ekonomisë kullosore Qendër, 6 (gjashtë) ngastra kullosore të ekonomisë kullosore Sinanaj, 1 (një) ngastër pyjore të ekonomisë pyjore Sinanaj, dhe 1 (një) ngastër pyjore të ekonomisë pyjore Dukaj-Luzat; i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- 3.Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi struktura përgjegjëse për pyjet e kullotat pranë Bashkisë Tepelenë.

4.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Sekretar i Këshillit

Valbona Çela



Miratuar me 12 vota
Vota Pro 12
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 01.07.2022

KRYETAR

ELVIS SHEHU


